

**MBI**  
**AUDITIMIN E USHTRUAR NË**  
**BASHKINË MALËSI E MADHE**

Raporti Përfundimtar i Auditimit të kryer në Bashkinë Malësi e Madhe, me objekt: “Mbi auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë të aktivitetit ekonomik dhe financiar”, për periudhën e veprimtarisë 01.01.2013 deri më 31.12.2015 dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 22, datë 28.03.2016 Bazuar në nenet mbështetje të neneve 10, 15 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Kontrolli i Lartë i Shtetit me shkresën nr. 1106/8 datë 28.03.2016, i ka rekomanduar z. Tonin Marinaj, Kryetar i Bashkisë Malësi e Madhe, zbatimin e masave të mëposhtme:

**A. MASA ORGANIZATIVE:**

**1. Gjetje nga auditimi:** Nuk kanë gjetur zbatim rekomandimet e lëna nga auditimi i mëparshëm dhe rikërkuar nga KLSH<sup>ja</sup> me shkresën nr. 1016/28, datë 30.06.2014, konkretisht:

- 7 masa organizative me mungesë të ardhurash në vlerën **2,384,000 lekë**.
- 8 masa shpërblim dëmi me vlerë **4,414,686 lekë**.
- 1 (një) masë administrative me vlerë **1,000,000 lekë**.

**1.1 Rekomandimi:** Bashkia Malësi e Madhe, të marrë masat duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore, për zbatimin e rekomandimeve të KLSH<sup>së</sup> paraqitur me shkresën nr. 1016/28, datë 30.06.2014 dhe të pa zbatuara plotësisht ose pjesërisht, për;

- 7 masave organizative me vlerën **3,384,000 lekë**, mungesë të ardhurash;
- 8 masa shpërblim dëmi me vlerë **4,414,686 lekë**;
- 1 (një) masë administrative me vlerë **1,000,000 lekë**;

Për zbatimin e rekomandimeve të njoftohet (me shkrim) KLSH<sup>ja</sup> në zbatim të nenit 15 germa “j”, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” dhe nenit 30, pika 2 e këtij ligji.

***Brenda muajit Qershor 2016***

**2. Gjetje nga auditimi:** Nuk janë implementuar kërkesat e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, konkretisht:

Nuk janë evidentuar risqet dhe masat për menaxhimin e tij, rregulla për administrimin dhe ruajtjen e aktiveve të qëndrueshme, gjurmët e auditimit, zonat me risk dhe rrjedhimisht nuk është përpiluar strategjia për menaxhimin e tij, si dhe nuk është hapur regjistri i riskut.

**2.1. Rekomandimi:** Bashkia Malësi e Madhe, të marrë masa dhe të vlerësojë shkeljet e konstatuara të kërkesave të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe të punojë për implementimin e kërkesave të ligjit.

***Menjëherë dhe në vijimësi***

**3. Gjetje nga auditimi:** Në auditimin e kryer, u konstatuan shmangie nga procedura e prokurimit, duke përdorur procedurë “Prokurim me vlerë të vogël” në vend të procedurës konkurruese të prokurimit, veprime në kundërshtim me kërkesat e kreut VI<sup>të</sup>, të VKM nr.

1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, pika 8 e nenit 40.

**3. 1. Rekomandimi:** Bashkia Malësi e Madhe, të marrë masat që në çdo rast shpenzimet operative (*art. 602*) dhe shpenzimet për investime (*art. 231*), të realizohen me procedurë prokurimi elektronik, duke mos u shmangur nga procedurat e prokurimit sipas dispozitave të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”.

*Në vijimësi*

**4. Gjetje nga auditimi:** Në Bashkinë Malësi e Madhe, nuk ka përfunduar procesi i depozitimit të dokumentacionit ligjorë në lidhje me transferimin e arkivave dhe pasurive të luajtshme dhe paluajtshme që kanë në administrim ish-Komunat, veprime në kundërshtim me VKM nr. 510, datë 10.06.2015 “Miratimin e Procedurave për Transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të patrupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacion tjetër zyrtar në Njësitë e Qeverisjes Vendore, të prekur nga riorganizimi administrativo-Territorial”.

**4.1. Rekomandimi:** Bashkia Malësi e Madhe, të marrë masa për përfundimin e procesit të depozitimit të dokumentacionit ligjorë në lidhje me transferimin e arkivave dhe pasurive të luajtshme dhe paluajtshme që kanë në administrim ish-Komunat.

*Brenda muajit Qershor 2016*

**5. Gjetje nga auditimi:** Në auditimin e kryer në dokumentacionin e tenderin me objekt “Roje private”, rezulton se për tre vitet operatori i vetëm fitues është subjekti “SH.R.S.F. A...A”. Ky operator për çdo njërin nga vitet, ka kryer shërbime jo kontraktuale për një afat 2 – 4 muaj, përtej vlerë së fondit prej 20% të kontratës shtesë, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” dhe Udhëzimin e MF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

**5.1. Rekomandimi:** Zyra e Financës në bashkëpunim me Kryetarin e Bashkisë Malësi e Madhe, të marrë masa për ndërprerjen e shërbimit të ruajtjes së objektit të pa kontraktuar gjatë vitit 2016, si dhe të mos lejohet marrëveshje të cilat nuk përcaktojnë përgjegjshmëri.

Gjithashtu të analizohen duke nxjerrë shkaqet, arsyet dhe përgjegjësinë e personave konkretë që kanë lejuar kryerjen e shërbimit të ruajtjes së objektit pa kontratë, e cila mund të sjellë pasojë negative në buxhetin e bashkisë.

*Brenda muajit Qershor 2016*

**6. Gjetje nga auditimi:** Nuk janë planifikuar dhe arkëtuar të ardhura nga taksa e fjetjes në hotel, megjithëse sipas regjistrimit të bizneseve, rezulton i regjistruar me aktivitet “hoteleri”, subjekti “A.H.”, për të cilën nuk është bërë i mundur arkëtimi i të ardhurave në vlerën **919,800 lekë**, e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë.

**6.1. Rekomandimi:** Zyra e Taksave Vendore, të marrë masa për saktësimin, njoftimin, kontabilizimin dhe arkëtimin e detyrimeve që rrjedhin nga mos menaxhimi i taksës së fjetjes në hotel të subjektit “A.H.”, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për të kërkuar arkëtimin vlerës **919,800 lekë**.

*Brenda muajit Qershor 2016*

**7. Gjetje nga auditimi:** Planifikimi i të ardhurave nga taksat e tarifave vendore nuk është sipas mundësive reale që ka Bashkia Malësi e Madhe, pasi të ardhurat janë planifikuar

më pak se sa ato duhen planifikuar në fakt, veprime në kundërshtim me dispozitat e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, ligjin nr. 7776, datë 22.12.1993 “Për Buxhetin Lokal”, ndryshuar me ligjin nr. 8399 datë 09.09.1998.

Mos menaxhimi më i mirë i resurseve që ka kjo njësi vendore, nuk ka bërë të mundur planifikimin e saktë të detyrimeve nga taksat e tarifatat vendore me vlerë **24,223 mijë lekë**, nga e cila: për vitin 2013 planifikimi i të ardhurave paraqitet më pak për vlerën 8,893 mijë lekë, për vitin 2014 planifikimi i të ardhurave paraqitet më pak për vlerën 8,008 mijë lekë dhe për vitin 2015 planifikimi i të ardhurave paraqitet më pak për vlerën 7,322 mijë lekë.

**7.1. Rekomandimi:** Bashkia Malësi e Madhe (Zyra e Taksave Vendore), të marrë masa, që për çdo vit buxhetor të bëjë planifikimin e saktë të të ardhurave nga taksat e tarifatat vendore, duke shfrytëzuar të gjithë dokumentacionin ligjorë e teknik, si dhe resurset që administron kjo njësi vendore.

*Në vijimësi*

**8. Gjetje nga auditimi:** Gjendja e debitorëve nga taksat e tarifatat vendore deri me 31.12.2015 paraqitet në vlerën **17,723,880 lekë**, vlerë e cila nga njëra periudhë në tjetrën ka ardhur në rritje, ku nga 2,498 mijë lekë në fund të vitit 2013 në fund të vitit 2014 paraqiten në vlerën 4,651 lekë ose shtuar për vlerën 2,153 lekë, ndërsa në vitin 2015 janë shtuar për vlerën 236 mijë lekë.

Nuk janë ndjekur procedurat ligjore në arkëtimin e debitorëve, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, nenit 12 të tij, Udhëzimin nr. 24, datë 02.09.2008, Kreu i XI “Mbledhja me forcë e detyrimeve”, pika 88 dhe pika 8932, pika 89.3 dhe pika 96.

**8.1. Rekomandimi:** Zyra e Taksave Vendore, për arkëtimin e **99 subjekteve** debitorë në datë 31.12.2015 me vlerë **17,723,880 lekë**, bazuar në nenin 70 pika 3-E drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore”, i ndryshuar, të nxjerr njoftim vlerësimet tatimore, duke ndjekur rrugët e mëposhtme:

-Tu dërgohen Bankave të nivelit të dytë urdhrat e bllokimit të llogarive bankare, bazuar në nenin 90, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, i ndryshuar.

-T’i kërkohet Drejtorisë Rajonale të Shërbimit të Transportit, vendosja e barrës siguroese (për mjetet) dhe Zyrës Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (për pasuritë) bazuar në nenin 91, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, i ndryshuar.

*Brenda muajit Qershor 2016*

**9. Gjetje nga auditimi.** Nuk janë zbatuar kërkesat e VKM<sup>së</sup> nr. 500, datë 14.08.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin në njësitë e qeverisjes vendore”, i ndryshuar dhe Udhëzimit të Ministrisë së Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit nr. 15, datë 30.06.2003 “Për mënyrën e paraqitjes nga njësitë e qeverisjes vendore të kërkesave për transferim në pronësi të tyre të pronave të paluajtshme publike”, mbi procedurat e transferimit të pronave në NJQV<sup>ve</sup>.

**9.1. Rekomandimi:** Bashkia Malësia e Madhe (Zyra e Kadastrës), të marrë masa për inventarizimin, evidentimin, vlerësim dhe regjistrimin e pronave në ZVRPP.

*Brenda muajit Qershor 2016*

**10. Gjetje nga auditimi:** Në auditimin e kryer, u konstatua se sektorët/zyrat e ish-Bashkisë Koplík kanë funksionuar pa një rregullore të brendshme të miratuar, ku të mund të përcaktoheshin detyrat përkatëse për çdo sektor/zyra dhe punonjës.

Gjithashtu nuk ka funksionuar dhe sektori i administrimit të pronave të bashkisë dhe ngritur grupe pune për inventarizimin, evidentimin dhe regjistrimin e pronave të Bashkisë, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, i ndryshuar, VKM nr. 500, datë 14.08.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin në njësitë e qeverisjes vendore”, i ndryshuar dhe Udhëzimit të Ministrisë së Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit nr. 15, datë 30.06.2003 “Për mënyrën e paraqitjes nga njësitë e qeverisjes vendore të kërkesave për transferim në pronësi të tyre të pronave të paluajtshme publike”.

**10.1. Rekomandimi:** Bashkia Malësi e Madhe, të hartojë dhe miratojë Rregulloren e Brendshme të funksionimit të strukturave të Bashkisë, duke përcaktuar detyrat për çdo zyrë/sector. Të miratojë strukturën e pronave publike dhe menaxhimit të aseteve, si dhe të ngrej grupet e punës për të plotësuar me dokumentacionin e mjaftueshëm e të nevojshëm pronat e transferuara nga institucionet që i kanë pasur në inventar ato, me qëllim vlerësimin paraprak dhe regjistrimet në kontabilitet, në përputhje me pikën 22, të VKM<sup>së</sup> nr. 500, datë 14.08.2001 “Për inventarizimin e pronave të Paluajtshme Shtetërore dhe Transferimin e Pronave në Njësitë e Qeverisjes Vendore”.

*Brenda muajit Qershor 2016*

**11. Gjetje nga auditimi:** Në auditimin e dokumentacionit mbi administrimin e aseteve, rezulton se **11 objekte** të Bashkisë Malësi e Madhe me sipërfaqe funksionale ndërtimi **1646 m<sup>2</sup>**, janë në përdorim nga persona privatë (*zënë forcërisht*). Bashkia Malësi e Madhe (ish-Bashkia Koplík) nuk ka ushtruar kompetencat ligjore për lirimin e tyre ose lidhjen e kontratave të qirasë së objekteve, sipas dispozitave të VKM nr. 529, datë 08.06.2011 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfitozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar me VKM nr. 54, datë 05.02.2014, i ndryshuar, Kapitulli III, pika 1/a,b, ku nga mos menaxhimi i tyre janë evidentuar të ardhura të munguara në vlerën **5,925,600 lekë**.

**11.1 Rekomandimi:** Bashkia Malësi e Madhe, të marrë masa për lirimin e pronave publike që shfrytëzohen padrejtësisht nga persona privat ose të mundësohet lidhja e kontratave të qiradhënies, duke përlllogaritur detyrimet që rrjedhin nga shfrytëzimi i pronave publike që nga hyrja në fuqi e VKM nr. 269, datë 12.03.2008 dhe VKM nr. 93, datë 07.02.2012 “Për miratimin e listës së inventarëve të pronave të paluajtshme shtetërore, në Bashkinë Malësi e Madhe (ish Bashkia Koplík), të Qarkut Shkodër”, për vlerën e qirasë së evidentuar prej **5,925,600 lekë**.

*Brenda muajit Qershor 2016*

**12. Gjetje nga auditimi:** Për gjodat e aplikuara nga Inspektoratin i Mbrojtjes Territoriale Vendor (IMTV) me vlerë 2,200,000 lekë, nuk është kërkuar në rrugë ligjore arkëtimi i tyre, veprim në kundërshtim me nenin 15, të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 “Për inspektimin e ndërtimit”.

Gjithashtu këto gjoda, nuk janë kontabilizuar në librat e llogarive dhe kontabilite si detyrime, pasi nga IMTV<sup>ja</sup> nuk janë përcjellë për veprime të mëtejshme në Zyrën e

Financës për regjistrim kontabël, veprime në kundërshtim me VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël”, kap I.

Për personat e dënuar me gjobë nuk është aplikuar kamatëvonesa në masën 2% për çdo ditë vonesë, për mos derdhje në afat të gjobës deri në një muaj në masën **1,320,000 lekë**, në kundërshtim me kreun IV-*Sanksionet* të nenit 16, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar.

**12.1. Rekomandimi:** Kryeinspektori i IMTV në bashkëpunim me Zyrën e Financës dhe Juridike, për çdo rast të bëj kontabilizimi në librat e llogarive të gjobave të aplikuara, të marrë masa dhe kërkoj në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës **3,520,000 lekë**, nga e cila; vlera 2,200,000 lekë gjoba nga ndërtimet e paligjshme dhe vlera 1,320,000 lekë kamatë vonesë, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, sipas pasqyrës.

Nr.	Emër Mbiemër	Nr. Vend	Data	Vlera e gjobës	Kamata
1.	S.M.	3	27.11.2012	500,000	300,000
2.	A.S.	1	23.04.2013	1,000,000	600,000
3.	R.T.	4	26.02.2015	500,000	300,000
4.	A.K.	3	31.10.2014	200,000	120,000
<b>TOTALI.....</b>				<b>2,200,000</b>	<b>1,320,000</b>

*Brenda muajit Qershor 2016*

**13. Gjetje nga auditimi:** Bashkia Malësi e Madhe, nuk ka miratuar Instrumentin e Përgjithshëm Ndërvendor dhe Planit të Detajuar Vendor, veprime në mospërputhje me nenin 40, të ligjit nr. 10119, datë 23.04.2009 “Për planifikimin e territorit”, i ndryshuar.

**13.1. Rekomandimi:** Zyra e Planifikimit Urban, të marrë masa për hartimin dhe miratimin në Këshillin Bashkiak dhe më pas në KKT, Instrumentin e Përgjithshëm Ndërvendor dhe Planit të Detajuar Vendor.

*Në vijimësi*

**14. Gjetje nga auditimi:** Në auditimin e kryer në dokumentacionin teknik të zbatimit, mbikëqyrjes, kolaudimit të punimeve të ndërtimit të administruara në dosjet teknike dhe verifikimi në terren në objektet: “*Rikonstruksioni i Murit Rrethues të Varrezave*” dhe “*Gjelbërim i rrugës së Lagjes Culaj*” Bashkia Malësi e Madhe, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera, si dhe mangësi në dokumentacion, veprime në kundërshtim me nenin 7 dhe 12, të ligjit nr. 8402 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Udhëzimin nr. 1, datë 16.06.2011 “Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 3, datë 15.2.2001 të KM “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, pika 4, nr. 3.3 paragrafi i dytë, Udhëzimi nr. 3, datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kreu II, pika 8.3, VKM nr. 514, datë 15.8.2007 “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, pikat 2, 3 dhe 9.

**15.1. Rekomandimi:** Bashkia Malësi e Madhe, të marrë masa për monitorimin e vazhdueshëm të investimeve, si gjatë periudhës së zbatimit të punimeve ashtu edhe në përfundim të tyre, nëpërmjet ngritjes së grupeve me specialistë të fushës, lidhur me dokumentacionin e objektit dhe zërat e punimeve dhe cilësinë e tyre.

*Në vijimësi*

## **B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI:**

Mbështetur në pjesën VI e kreut I të neneve 105-109, të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë” dhe pika 93 e Kapitullit IV-*Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve*, të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011”Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, titullari i njësisë publike (Nëpunësit Autorizues), të nxjerrë aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (padi gjyqësore), duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit (Nëpunësi zbatues), të ndjekë procesin dhe të kryej regjistrimet e nevojshme kontabile përfundimtare, me qëllim për shpërblimin e dëmit në vlerën **18,441,036 lekë**, *si më poshtë*.

**1. Gjetje nga auditimi:** Në auditimin e shpenzimeve me bankë, u konstatua se janë kryer shpenzime të telefonisë së lëvizshme (celular) me fondet operative të bashkisë, veprime në shkelje të disiplinës financiare me dëm ekonomik me vlerë **455,129 lekë**, në kundërshtim me kërkesat e VKM<sup>së</sup> nr. 864, datë 23.04.2010 “Për pajisjen me numër telefoni celular të personave juridik dhe publik”.

Gjithashtu nga auditimi i mëparshëm i KLSH<sup>së</sup> është konstatuar e njëjta shkelje për të cilën është lënë rekomandim shpërblim dëmi, por nga ana e ish-Bashkisë Koplík është refuzuar ky rekomandim, duke kërkuar zgjidhje në Gjykatë, ku megjithëse gjykata akoma nuk është shprehur me vendim përfundimtar mbi këtë çështje, Zyra e Financës ka vijuar kryerjen e pagesave të kundërligjshme për shpenzime të telefonisë së lëvizshme (celular).

**1.1. Rekomandimi:** Bashkia Malësi e Madhe, të analizojë shkaqet e likuidimit të shpenzimeve të telefonisë së lëvizshme (celular) me vlerë **455,129 lekë**, pa përfunduar procesi gjyqësor i hapur, të nxjerrë përgjegjësitë për veprimin e kryera në shkelje të disiplinës financiare të fondeve të Buxhetit, duke përcaktuar efektet për çdo punonjës ose ish-punonjës të Bashkisë Koplík (sot Bashkia Malësi e Madhe).

*Brenda muajit Qershor 2016*

**2. Gjetje nga auditimi:** Në auditimin e kryer, u konstatua se sipas situacioneve mujore të shërbimit për pastrimin e Qytetit të Bashkisë Koplík, janë kryer shërbime për "*lagie rrugësh*" në periudha të cilat nuk kanë qenë të parashikuara në kontratën nr. 616/1, datë 25.10.2012 e lidhur midis ish-Bashkisë Koplík dhe subjektit “B...I, duke evidentuar një dëm ekonomik në **vlerën 66,000 lekë**.

**2.1. Rekomandimi:** Bashkia Malësi e Madhe, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për të kërkuar shpërblimin e dëmit në vlerën **66,000 lekë**, në ngarkim të **z. XH.B.** me detyrë ish-supervizor.

*Brenda muajit Qershor 2016*

**3. Gjetje nga auditimi:** Në një rast është konstatuar moszbatim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël “*Mbikëqyrje punimesh*”, veprim në kundërshtim me Kreu VI pika 2/ b, të VKM nr. 1, datë 10.01.2007, i ndryshuar, me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, pikën 5, të Udhëzimi nr. 2, datë 28.03.2013 “Për procedurën e prokurimeve me vlerë të vogël”, i ndryshuar, si dhe nenin 15, 16 dhe 22, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 për “Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, **me dëm ekonomik në vlerën 379,974 lekë**.

**3.1. Rekomandimi:** Bashkia Malësi e Madhe, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për të kërkuar shpërblimin e dëmit në vlerën **379,974 lekë**, ndaj punonjësve:

**-Znj. E.Z. për vlerën 126,658 lekë**, në cilësinë e kryetarit të komisionit të blerjeve të vogla.

**-Znj. N.D. për vlerën 126,658 lekë**, në cilësinë e anëtarit të komisionit të blerjeve të vogla.

**-Znj. A.I. për vlerën 126,658 lekë**, në cilësinë e anëtarit të komisionit të blerjeve të vogla.

#### *Brenda muajit Qershor 2016*

**4. Gjetje nga auditimi:** Në drejtim të shpenzimeve të kryera për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim brenda vendit, u konstatuan veprime në kundërshtim me VKM nr. 997, datë 10.10.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit”, kapitulli i III-të, pika 1, 3, germa “b”, paragrafi i dytë dhe tretë dhe Udhëzimin e MF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pasi janë bërë likuidime pa dokumentacion ligjor (*kuponi tatimore ose dëftesa tatimore*), veprime në shkelje të disiplinës financiare me **dëm ekonomik në vlerën 366,000 lekë**.

**4.1. Rekomandimi:** Bashkia Malësi e Madhe, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për të kërkuar shpërblimin e dëmit në vlerën **366,000 lekë**, ndaj personave: A.L. në vlerën 21,000 lekë, A.B. në vlerën 12,000 lekë, B.M. në vlerën 21,000 lekë, B.C. në vlerën 12,000 lekë, B.P. në vlerën 12,000 lekë, D.M. në vlerën 12,000 lekë, E.Z. në vlerën 21,000 lekë, E.K. në vlerën 21,000 lekë, E.D. në vlerën 12,000 lekë, E.L. në vlerën 21,000 lekë, E.P. në vlerën 21,000 lekë, F.M. në vlerën 12,000 lekë, G.GJ. në vlerën 21,000 lekë, I.O. në vlerën 21,000 lekë, K. Z. në vlerën 12,000 lekë, K.K. në vlerën 21,000 lekë, N.D. në vlerën 9,000 lekë, S.H. në vlerën 21,000 lekë, T.N. në vlerën 21,000 lekë, V.P. në vlerën 21,000 lekë dhe XH.P. në vlerën 21,000 lekë.

#### *Brenda muajit Qershor 2016*

**5. Gjetje nga auditimi:** Në një rast përcaktimi i fituesit është bërë në kundërshtim me pikën 5, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, duke përcaktuar fitues një subjekt i cili është klasifikuar i teti në radhë, duke evidentuar një dëm ekonomik në vlerën **59,000 lekë**.

**5.1. Rekomandimi:** Bashkia Malësi e Madhe, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për të kërkuar shpërblimin e dëmit në vlerën **59,000 lekë**, ndaj punonjësve:

**-Znj. E.Z. për vlerën 19,800 lekë**, në cilësinë e kryetarit të komisionit të blerjeve të vogla.

**-Znj. N.D. për vlerën 19,600 lekë**, në cilësinë e anëtarit të komisionit të blerjeve të vogla.

**-Znj. A.I. për vlerën 19,600 lekë**, në cilësinë e anëtarit të komisionit të blerjeve të vogla.

#### *Brenda muajit Qershor 2016*

**6. Gjetje nga auditimi:** Në auditimin e kontratës “*Pastrim Qyteti Bashkia Koplík*”, u konstatua se nuk ka gjetur zbatim neni 14, i kontratës nr. 616/1, datë 25.10.2012 “Për

sipërmarrjen e shërbimeve publike të pastrimit, gjelbërimit, dekorimit dhe mirëmbajtjes të varrezave të qytetit të Koplikut, lidhur midis ish-Bashkisë Koplík dhe subjektit "B...I", pasi:

Mjete pronë e Bashkisë, kaluar me inventarë (me kartelë) që në vitin 2009 personit F.B. i cili është përfaqësues ligjor i subjektit sipërmarrës "B...I".

Ndaj subjektit sipërmarrës nuk është aplikuar dhe mbajtur detyrimi mbi qiranë e përdorimit të këtyre mjeteve, duke lejuar përdorimin e tyre për nevoja personale dhe përfituar të ardhura pa shpërblim, si dhe rritur vlerën e amortizuar të mjeteve.

Gjithashtu ndaj subjektit nuk është bërë i mundur arkëtimi i vlerës së qirasë së lidhur për vitin 2013 me vlerë **96,000 lekë**, veprime në kundërshtim me nenin 12, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", si dhe pikat 11 dhe 12, 35 dhe 36, të Udhëzimit të MF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik".

**6.1. Rekomandimi:** Zyra e Financës në bashkëpunim me Zyrën Juridike, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore, për llogaritjen dhe vlerësimin e vlerës së amortizuar të dy mjeteve në pronësi të Bashkisë dhe përdorur nga sipërmarrësi i pastrimit të Qytetit Bashkia Koplík, subjekti "B...I", duke llogaritur dhe arkëtuar dëmshpërblimin e përdorimit të mjeteve nga viti 2009 deri në datën e mbylljes së kontratës së pastrimit (Qershor 2015), si dhe arkëtimin e vlerën e qirasë së vitit 2013 me vlerë **96,000 lekë**.

*Brenda muajit Qershor 2016*

**7. Gjetje nga auditimi:** Në auditimin e veprimeve mbi konsumin e karburantit, u konstatua se nuk është bërë sipas pikës 38, të Udhëzimit të MF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik". Sasia e naftës është përdorur nga mjet i vetëm që ka Komuna në përdorim dhe përdorej nga ish-Kryetari i Komunës (*Mitsubishi me targë MA2249B*), deri në momentin e daljes jashtë përdorimit dhe më pas me mjetin tip "Benz" me targë AA 717 AV, veprim në kundërshtim me ligji nr. 10160, datë 15.10.2009, ka pësuar ndryshime me ligjit nr. 169/2013 Për disa ndryshime në ligjin nr. 10160, datë 15.10.2009 "Për rregullimin e shërbimit të transportit për funksionarët publik dhe nëpunësit civil", me dëm ekonomik në vlerën **479,615 lekë**.

**7.1. Rekomandimi:** Bashkia Malësi e Madhe, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për të kërkuar shpërblimin e dëmit në vlerën **479,615 lekë**, në ngarkim të **z. I.R.** me detyrë ish-Kryetar i Komunës Qendër.

*Brenda muajit Qershor 2016*

**8. Gjetje nga auditimi:** Në një rast janë kryer shpenzime për "*pastrim mbeturinash*", pa përcaktuar vlerën e fondit limit të akorduar për kryerjen e këtij shërbimi, veprime në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", Kreu VI pika 2/b, i ndryshuar, Udhëzimi nr. 2, datë 28.03.2013 "Për procedurën e prokurimeve me vlerë të vogël", i ndryshuar, pika 5, Udhëzimi plotësues nr. 3, datë 17.01.2014 "Për Zbatimin e Buxhetit të viti 2014", neni 15 dhe 22, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 për "Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin".

Kryerja e këtij shpenzimi (pastrim mbeturinash) është një shpenzim i paplanifikuar në buxhetin e kësaj njësie vendore dhe për më tepër një mbishpenzim i pa argumentuar, pasi me Vendim të KK është miratuar fondi dhe struktura organizative (*me 3 punonjës për*



vitet 2013 – 2014 dhe 7 punonjës për vitin 2015), si dhe mjete përkatëse të cilat do të realizojnë shërbimin e pastrimit të territorit të Komunës Kastrat.

Subjekti “S...J”, i cili është shpallur fitues për kryerjen e këtij shpenzimi, nuk plotëson kriteret ligjore, pasi sipas ekstraktit të QKR aktiviteti i tij është “*tregti me pakicë artikuj të ndryshme, bar kafe dhoma me qira për pushues*”, me adresë vendodhje biznesi Lezhë, lagjja Besëlidhja, rruga Kosova, dhe nuk ka asnjë lidhje me procesin e pastrimit të mbeturinave.

Po sipas ekstraktit historik ky subjekt nuk ka mjetet e nevojshme për kryerjen e këtij shërbimi (*makineritë dhe numrin e punonjësve*), veprime në kundërshtim me dispozitat e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, Udhëzimit të MF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve të Njesisë së Sektorit Publik”, si dhe nenet 5, 8, 10 dhe 21, të ligjit nr 8094, datë 21.03.1996 “Për largimin publik të mbeturinave”, veprime këto të cilat tregojnë mos efektivitet dhe efikasitet në përdorimin e fondeve të buxhetit të shtetit, duke shpenzuar pa dokumentacion ligjor mbështetës e argumentues, dhe në shkelje të disiplinës financiare me dëm ekonomik në vlerën **396,900 lekë**.

**8.1. Rekomandimi:** Bashkia Malësi e Madhe, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për të kërkuar shpërblimin e dëmit në vlerën **396,900 lekë**, ndaj punonjësve:

**-Z. B.B. për vlerën 132,300 lekë**, në cilësinë e kryetarit të komisionit të blerjeve të vogla.

**-Z. P.M. për vlerën 132,300 lekë**, në cilësinë e anëtarit të komisionit të blerjeve të vogla.

**-Z. A.M. për vlerën 132,300 lekë**, në cilësinë e anëtarit të komisionit të blerjeve të vogla.

*Brenda muajit Qershor 2016*

**9. Gjetje nga auditimi:** Në auditimin e dokumentacionit mbi përdorimin e karburantit, u konstatua se fletë daljet e karburantit nuk kishin numër kronologjik, pasi në shumë raste ishin paraqitura me fraksion. Hyrjet dhe daljet e karburantit nuk janë bërë me tolona, por në sasi dhe në adresë të ish-Kryetarit të Komunës dhe shoferit të kamionit për pastrimin e mbeturinave. Në fletë-udhëtimet e paraqitura, evidentohet fakti se një sasi e konsiderueshme karburanti është përdorur nga ish-Kryetari i Komunës Kastrat, i cili ka në ngarkim mjetin e komunës “*Tip Jeep me targë MA 1521 B*”.

Përdorimi i karburanti nga ish-Kryetari i Komunës, është veprim i cili bie ndesh me ligji nr. 10160, datë 15.10.2009, ka pësuar ndryshime me ligjit nr. 169/2013 Për disa ndryshime në ligjin nr. 10160, datë 15.10.2009 “Për rregullimin e shërbimit të transportit për funksionarët publik dhe nëpunësit civil”, dhe në shkelje të disiplinës financiare me **dëm ekonomik në vlerën 332,098 lekë**.

**9.1. Rekomandimi:** Bashkia Malësi e Madhe, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për të kërkuar shpërblimin e dëmit në vlerën **332,098 lekë**, në ngarkim të **z. V.P.** me detyrë ish-Kryetar i Komunës Kastrat.

*Brenda muajit Qershor 2016*

**10. Gjetje nga auditimi:** Për vitet 2013-2015, janë kryer shpenzime të telefonisë së lëvizshme me fondet operative të Komunës, për Kryetarin e Komunës Kastrat me **vlerë 378,949 lekë**, veprime në shkelje të disiplinës financiare me dëm ekonomik dhe në

kundërshtim me kërkesat e VKM nr 864, datë 23.04.2010 “Për pajisjen me numër telefoni celular të personave juridik dhe publik”.

**10.1. Rekomandimi:** Bashkia Malësi e Madhe, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për të kërkuar shpërblimin e dëmit në vlerën **378,949 lekë**, ndaj punonjësve:

**Z. V.P. për vlerën 189,475 lekë**, me detyrë ish-Kryetar i Komunës Kastrat,.

**Z. B.B. për vlerën 189,475 lekë**, me detyrë ish-P/Zyrës së Financës, Komuna Kastrat.

*Brenda muajit Qershor 2016*

**11. Gjetje nga auditimi:** Në tenderin e zhvilluar me objekt “*Blerje kazan mbeturinash*”, me vlerë 5,625,000 lekë (pa TVSH).

Bashkia Koplík me vendim nr. 50, datë 26.12.2013, ka nxjerrë fitues operatorin “N...K” me ofertë ekonomike në shumën 5,444,000 lekë (pa tvsh). Fituesit të tenderit i është kërkuar sqarim dhe plotësim dokumenti të bilancit të vitit 2012, pasi nuk dukej vula origjinale e subjektit dhe nuk është i noterizuar. OE janë njoftuar me mesazh elektronik nëpërmjet Agjencisë Prokurimit Publik për paraqitjen e tyre në Bashkinë Koplík me datë 13.12.2013, për rregullimin e gabimeve të vogla të dokumentacionit, por që nuk prekin interesat ekonomike dhe sjelljen e mostrave.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave (KVO), në procesverbalin përmbledhës për titullarin e autoritetit kontraktor është paraqitur renditja e ofertave, duke vlerësuar me ofertë më të ulët vlera 4,800,000 lekë (pa tvsh) paraqitur nga subjekti “I...R” shpk me Nipt J60027009T.

Nga veprimet e mëtejshme të autoritetit kontraktor, rezulton i favorizuar operatori “N...K” me ofertë ekonomike në vlerën 5,444,000 lekë (pa tvsh), por në fakt fitues duhet të ishte subjekti “Iliari” shpk me vlerë oferte 4.800,000 lekë (pa tvsh), ose më pak se operatori fitues për vlerën **772,800 lekë**, e cila përbën dëm ekonomik.

**11.1. Rekomandimi:** Bashkia Malësi e Madhe, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për të kërkuar shpërblimin e dëmit në vlerën **772,800 lekë**, ndaj punonjësve:

**-Z. XH.B. për vlerën 154,560 lekë**, në cilësinë e kryetarit të KVO.

**-Znj. I.R. për vlerën 154,560 lekë**, në cilësinë e anëtarit të KVO.

**-Z. A.RR. për vlerën 154,560 lekë**, në cilësinë e anëtarit të KVO.

**-Z. XH.D. për vlerën 154,560 lekë**, në cilësinë e anëtarit të KVO.

**-Znj. V.Z. për vlerën 154,560 lekë**, në cilësinë e anëtarit të KVO.

*Brenda muajit Qershor 2016*

**12. Gjetje nga auditimi:** Në tenderin e zhvilluar me objekt “*Gjelbërim i Rrugës Cula*”, me vlerë 2,483,436 lekë (pa tvsh). Operatori i skualifikuar “D...A”, ka paraqitur formularin e ankesës për prokurimin pranë autoritetit kontraktor me përshkrimin se nga ana e Bashkisë Koplík nëpërmjet një mesazhi elektronik është bërë njoftimi për skualifikim me arsyetimin se në “listën e makinerive “ për mjetin fadromë me goma nuk është paraqitur leja e qarkullimit dhe siguracioni i mjetit.

Çështja e ankimuar është shqyrtuar nga avokati i prokurimeve, i cili pasi ka bërë hetim administrativ ka vendosur rrëzimin e ankesës së firmës “D...A” shpk. Nga verifikimi i aktit administrativ në tërësinë e tij, rezulton se avokati i prokurimeve ka marrë

informacion vetëm nga autoriteti kontraktor dhe nuk ka konkluduar nëse subjekti mund të plotësojë kërkesat e mësipërme të cilat nuk cenojnë interesat ekonomike të zhvillimit të tenderit, pasi oferta e paraqitur është më e ulët për shumën 637,956 lekë dhe e nxjerrë operatorin në vend të parë dhe fitues. Nga verifikimi dokumenteve hetimore nuk ka prononcim të subjektit ankimues për mungesën e dokumentacionit të fadromës. Mos vlerësimi i drejtë i ankimimit ka shkaktuar dëm ekonomik në shumën **637,956 lekë**.

**12.1. Rekomandimi:** Bashkia Malësi e Madhe, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për të kërkuar shpërblimin e dëmit në vlerën **637,956 lekë**, ndaj punonjësve:

-Z. R.S. për vlerën **212,652 lekë**, në cilësinë e kryetarit të KVO.

-Z. F.B. për vlerën **212,652 lekë**, në cilësinë e anëtarit të KVO.

-Znj. E.Z. për vlerën **212,652 lekë**, në cilësinë e anëtarit të KVO.

*Brenda muajit Qershor 2016*

**13. Gjetje nga auditimi:** Në tenderin e zhvilluar me objekt “Ndërtim i rrugës Murriq-Qendër,Vukel”, me vlerë 27,228,167 lekë (pa TVSH), është lidhur kontrata pa nr, prot, datë 10.12.2012, midis Autoritetit Kontraktor përfaqësuar nga Kryetari z. Gj.D. dhe Operatorit Ekonomik subjekti “V...J“ sh.p.k. përfaqësuar nga F.V.

Në zbatim të nenit 4, të kontratës është caktuar afati 230 ditë ose 7.6 muaj kalendarikë pas lidhjes së kontratës që rezulton të jetë data 31.07. 2013, afat i fundit i përfundimit të punimeve.

Me shkresë nr. 145, datë 17.12.2014, shoqëria ka njoftuar autoriteti kontraktor “Komuna Kelmend” për përfundimin e punimeve, në zbatim të kontratës datë 10.12.2012, i cili rezulton me vonesë **për 457 (katërqind pesëdhjeteshtatë) ditë vonesa**, nga data 01.08.2013 deri më datë 17.12.2014.

Për ditë vonesat në realizimin e kontratës, nga llogaritja rezulton një efekt financiar në vlerën **6,800,757 lekë**, dëm ekonomik, pasi ndërprerja e punimeve nuk vjen për shkaqe objektive të cilat janë përcaktuar në nenin 10 të kontratës.

**13.1. Rekomandimi:** Bashkia Malësi e Madhe, të marrë masa dhe të analizojë shkaqet e mos zbatimit të afateve për punimet e kontratuarar, të vlerësojë marrëdhënien juridike me subjektin, duke nxjerrë përgjegjësitë ligjore dhe financiare për diferencat e penaltiteteve dhe të kërkojë arkëtimi për ditë vonesat nga subjekti “V...J”, në vlerën **6,800,757 lekë**.

*Brenda muajit Qershor 2016*

**14. Gjetje nga auditimi:** Sipas të dhënave të dokumentacionit të audituar për taksën e ndërtesë, u konstatua se nuk është bërë i mundur evidentimi dhe arkëtimi i vlerës **987,750 lekë në 21 subjekte**, e ardhur e munguara me dëm në buxhetin e Bashkisë, në kundërshtim me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar.

**14.1. Rekomandimi:** Zyra e Taksave Vendore, të marrë masa për saktësimin, kontabilizimin dhe arkëtimin e detyrimit të taksës së ndërtese në **21 subjekte me vlerë 987,750 lekë**, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore (*Sipas pasqyrës aneks nr. 5, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar Auditimit*).

*Brenda muajit Qershor 2016*

**15. Gjetje nga auditimi:** Zyra e Taksave Vendore nuk ka planifikuar dhe arkëtuar të ardhura nga taksa e reklamës, megjithëse në rrugët kryesore të Bashkisë, evidentohen

subjekte që kanë vendosur reklama, veprimet në kundërshtim me dispozitat e ligjit 9632, datë 20.10.2006 “Për sistemimin e taksave vendore”, i ndryshuar, si dhe Vendimet e Këshillit Bashkiak nr. 29, datë 07.12.2012; VKB nr. 3, datë 07.02.2014; VKB nr. 1, datë 16.02.2015, ku si rezultat i mos administrimit, nuk është bërë i mundur evidentimi dhe arkëtimi i taksës së reklamës në **7 subjekte me vlerë 3,122,550 lekë**.

**15.1. Rekomandimi:** Zyra e Taksave Vendore, të marrë masa për saktësimin, kontabilizimin dhe arkëtimin e detyrimit të taksës së reklamës në **7 subjekte me vlerë 3,122,550 lekë**, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore (*Sipas pasqyrës aneks 6, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

*Brenda muajit Qershor 2016*

**16. Gjetje nga auditimi:** Në analizën e pasqyrave financiare (pasiv-aktivi), konstatohet se në aktiv në llog. 212-*Ndërtime e konstruksione*, paraqitet vlera 3,348,542 lekë objekti “*tregu i qytetit*”, ndërtuar nga Bashkia Koplík (sot Bashkia Malësi e Madhe). Ky objekt (aset) me sipërfaqe 122 m<sup>2</sup>, nuk menaxhohej nga Bashkia por nga pronari i truallit, për të cilën nuk është bërë i mundur arkëtimi i të ardhurash nga përdorimi i tij, në formë qiraje në zbatim të dispozitave të kapitullit III, të VKM nr. 529, datë 08.06.2011, i shfuqizuar me VKM nr. 54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfitozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, për të cilën janë evidentuar mungesë të ardhurash me dëm ekonomik në vlerën **439,200 lekë**.

**16.1. Rekomandimi:** Bashkia Malësi e Madhe, të marrë masa për lidhjen e kontratës së qiradhënies sipas legjislacionit në fuqi, duke saktësuar, kontabilizuar dhe arkëtuar detyrimet e qirasë në vlerën **439,200 lekë**, nga shfrytëzimi i pronës publike të Bashkisë ose lirim të shfrytëzimi i padrejtë.

*Brenda muajit Qershor 2016*

**17. Gjetje nga auditimi:** Në auditimin e dokumentacionit mbi hyrjet dhe daljet e karburantit për periudhën 2013 deri më 30.06.2015, u konstatua diferenca në sasinë prej 200 litra me vlerë 37,290 lekë. Kjo sasi karburanti as nuk është gjendje në magazinë dhe as justifikohet me dokumente përdorimi i tij, veprime në kundërshtim me nenin 8, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” dhe Udhëzimin e MF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pikat 12,19,36 dhe 38, dhe në shkelje të disiplinës financiare me dëm ekonomik në vlerën **37,290 lekë**.

**17.1. Rekomandimi:** Bashkia Malësi e Madhe, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për të kërkuar shpërblimin e dëmit në vlerën **37,290 lekë**, në ngarkim të punonjësit **z. Q.I.** me detyrë llogaritar arkëtar.

*Brenda muajit Qershor 2016*

**18. Gjetje nga auditimi:** Në auditimin e dokumentacionit teknik të zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike në objektin “*Rikonstruksioni i rrethimit të varrezave Koplík*”, si dhe verifikimi në terren rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në vlerën **852,943 lekë** (pa t.v.sh), veprime në kundërshtim me nenin 7 dhe 12, të ligjit nr. 8402 “*Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit*”, i ndryshuar, kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 50, datë 13.10.2014 të lidhur mes ish – Titullarit të Autoritetit Kontraktor Bashkia Koplík dhe bashkimit të operatorëve ekonomik “*G...A*” sh.p.k dhe “*RR.G.*” sh.p.k,

kontratën me nr. 54, datë 13.10.2014 për mbikëqyrjen e punimeve, konkretisht pikat 2, 5, 6 dhe 22, kontrata me nr. 56, datë 17.11.2014 për kolaudimin e punimeve, konkretisht neni 7 germa A dhe C, Udhëzimin nr. 1 datë 16.06.2011 “Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 3, datë 15.2.2001 të KM “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, pika b, nr. 3.3 paragrafi i dytë dhe pika 4 paragrafi i katërt.

**18.1. Rekomandimi:** Bashkia Malësi e Madhe, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për të kërkuar shpërblimin e dëmit në vlerën **852,943 lekë** (pa tvsh) nga bashkimi i operatorëve ekonomik “**G...A**” dhe “**Rr.G.**” *sh.p.k.*, në cilësinë e sipërmarrësve sipas kontratës nr. 50, datë 13.10.2014.

*Brenda muajit Qershor 2016*

**19. Gjetje nga auditimi:** Në auditimin e dokumentacionit teknik të zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike në objektin “*Gjelbërim i rrugës së Lagjes Culaj*”, Koplík, si dhe verifikimi në terren rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në vlerën **1,780,125 lekë** (pa tvsh), veprime në kundërshtim me nenin 7 dhe 12, të ligjit nr. 8402 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 703, datë 10.12.2012 të lidhur mes ish – Titullarit të Autoritetit Kontraktor Bashkia Koplík dhe operatorit ekonomik “**G...A**” *sh.p.k.*, kontratën me nr. 703/1, datë 10.12.2012 për mbikëqyrjen e punimeve, konkretisht pikat 2 dhe 20 dhe kontratën nr. 821/1, datë 08.01.2013 për kolaudimin e punimeve.

**19.1. Rekomandimi:** Bashkia Malësi e Madhe, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për të kërkuar shpërblimin e dëmit në vlerën **1,780,125 lekë** (pa tvsh) nga operatori ekonomik “**G...A**” *sh.p.k.*, në cilësinë e sipërmarrësit sipas kontratës nr. 703, datë 10.12.2012.

*Brenda muajit Qershor 2016*

## **B/1. MASA PËR MOS PËRDORIMIN ME EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE:**

**1. Gjetje nga auditimi:** Në auditimin e procedurave të prokurimit me vlera të mëdha (tendera), u konstatuan se në **2 raste me vlerë kontrate 5,476,800 lekë** (me tvsh), ka mos përmbushje të rregullave të caktuara në procedurat e prokurimit, mos përdorim me efektivitet, efencë dhe ekonomikitet të fondeve publike të vëna në dispozicion, si dhe përdorimin me diferencë negative në fondet buxhetore në vlerën totale **4,878,000 lekë**. Vlerë kjo që përcaktohet në prokurimin me objekt; “*Blerje automjeti*” *ish-Komuna Qendër në vlerën 2,470,000 lekë dhe “Blerje automjeti” ish-Komuna Kelmend, në vlerën 1,595,000 lekë*, veprime në kundërshtim me nenin 1, 2 dhe 24, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe kreu V, pika 1/a dhe pika 4/h, të VKM nr. 1, datë 10.1.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar.

**1.1. Rekomandimi:** Bashkia Malësi e Madhe, të marrë masa, të analizojë me grup pune të veçantë, duke nxjerrë shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për mos përdorimin me efektivitet, ekonomikitet dhe efencë të fondeve publike, për 2 procedurat e prokurimeve me efekte negative në përdorimin e fondeve publike në vlerën **4,878,000 lekë**, duke vënë theksin në rritjen e vlerës së shtuar nga përdorimi i fondeve publike në shërbim të komunitetit.

## C. MASA DISIPLINORE:

Mbështetur në nenin 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, nenin 58, të ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013 “Për Nëpunësin Civil”, neneve 11 dhe 37, të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1996 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe kontratës individuale të punës, **i rekomandoj Kryetarit të Bashkisë**, të vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke vendosur marrjen e masave disiplinore në raport me shkeljet e konstatuara, për **16 punonjësit** e mëposhtëm:

### C/1. “Largim nga shërbimi civil”, neni 58, germa “ç”.

#### **1. Znj. E.Z. me detyrë ish-Përgjegjëse e Zyrës së Financës, për:**

-Mos zbatim të rekomandimeve të KLSH<sup>së</sup> nga auditimet e mëparshme për dëmin ekonomik në vlerën **4,414,686 lekë**, veprime në kundërshtim me nenet 15 dhe 30, të ligjit nr. 154/2015, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, pjesën VI, kreu I, nenet 105-109, të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë” dhe pikën 93 e Kapitullit IV-*Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve*, si dhe Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, të Ministrit të Financave.

-Mos evidentim dhe arkëtim të të ardhurave në shumën **439,200 lekë**, nga objekti “*Tregu i Qytetit*”, veprime në kundërshtim me VKM nr. 529, datë 08.06.2011 “Për përcaktimin e kritereve, procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira ose enfiteozë të pronës shtetërore”, dhe aktet në zbatim të tij, i shfuqizuar me VKM nr. 54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”.

-Mangësitë e konstatuara në shkelje të disiplinës financiare me dem ekonomik në vlerën **438,974 lekë**, në cilësinë e Kryetarit të Komisionit të blerjeve të vogla, nga mos zbatimi i dispozitave të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullimet e prokurimit publik”, i ndryshuar me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, nenin 4, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, si dhe udhëzimin e MF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

-Mos zbatimin e dispozitave të VKM nr 864, datë 23.04.2010 “Për pajisjen me numër telefoni celular të personave juridik dhe publik” dhe procesit gjyqësor të nisur, në kryerjen e pagesave të shpenzimeve të telefonisë së lëvizshme, për vlerën **455,129 lekë**.

-Mos zbatim të kushteve të kontratës së lidhur midis sipërmarrësit të shërbimit për pastrimin e qytetit të Bashkisë Malësi e Madhe (ish-Bashkisë Koplík) dhe ish-Kryetarit, të nenit 14, të kontratës nr. 616/1, datë 25.10.2012 “Për sipërmarrjen e shërbimeve publike të pastrimit, gjelbërimit, dekorimit dhe mirëmbajtjes të varrezave të qytetit të Koplíkut, për mos aplikim dhe mbajtje të detyrimit mbi qiranë e përdorimit të mjeteve, duke lejuar përdorimin e tyre për nevoja personale, dhe përfituar të ardhura pa shpërblim ndajë buxhetit të Bashkisë Koplík (sot Bashkia Malësi e Madhe), njëkohësisht dhe rritur vlerën e amortizuar të këtyre mjeteve, si dhe mos arkëtim të vlerës së qirasë së mjetit për vitin 2013 në shumën **96,000 lekë**, veprime në kundërshtim me dispozitat e ligjit nr.

10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe Udhëzimit të MF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve”.

## **C/2. “Vërejtje” deri në “Largim nga Shërbimi Civil”, neni 58.**

### **1. Znj. G.H. me detyrë Juriste në Bashkinë Malësi e Madhe, për:**

-Mos zbatim të rekomandimeve të KLSH-së nga auditimet e mëparshme për dëmin ekonomik në vlerën **4,414,686 lekë**, veprime në kundërshtim me nenet 15 dhe 30, të ligjit nr. 154/2015, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, pjesën VI, kreu I, nenet 105-109, të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë” dhe pikën 93 e Kapitullit IV-*Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve*, si dhe Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, të Ministrit të Financave.

-Mos zbatim të kushtet e kontratës së lidhur midis sipërmarrësit të shërbimit për pastrimin e qytetit të Bashkisë Malësi e Madhe (ish-Bashkisë Koplík) dhe ish-Kryetarit, të nenit 14, të kontratës nr. 616/1, datë 25.10.2012 “Për sipërmarrjen e shërbimeve publike të pastrimit, gjelbërimit, dekorimit dhe mirëmbajtjes të varrezave të qytetit të Koplíkut, për mos aplikim dhe mbajtje të detyrimit mbi qiranë e përdorimit të mjeteve, duke lejuar përdorimin e tyre për nevoja personale, dhe përfituar të ardhura pa shpërblim ndajë buxhetit të Bashkisë Koplík (sot Bashkia Malësi e Madhe), njëkohësisht dhe rritur vlerën e amortizuar të këtyre mjeteve, si dhe mos arkëtim të vlerës së qirasë së mjetit për vitin 2013 në shumën **96,000 lekë**, veprime në kundërshtim me dispozitat e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe Udhëzimit të MF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve”.

-Mos marrjen e kërkesave zyrtare nga strukturat përkatëse e ish-Bashkisë Koplík, për të argumentuar domosdoshmërinë e kryerjes së prokurimit gjatë vitit 2013,2014 dhe 2015, veprime në kundërshtime me kërkesat e Urdhrit nr. 33, datë 11.07.2013 “Për gjurmët standarde të auditimit për prokurimin me vlerë të vogël dhe ta lartë” dhe VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar.

-Mos ndërprerjen e marrëdhënie kontraktuale me subjektin “A...A”, pas përfundimit të afatit të kontratave nr. 36, datë 24.04.2013, nr. 17, datë 14.04.2014 dhe nr. 14 datë 23.04.2015.

### **2. Z. D.R. me detyrë Kryeinspektor i Inspektoratit të Mbrojtjes Territorit Vendor (IMTV), për:**

-Mos zbatim të rekomandimeve të KLSH-së nga auditimet e mëparshme për dëmin ekonomik në vlerën **1,000,000 lekë**, veprime në kundërshtim me nenet 15 dhe 30, të ligjit nr. 154/2015, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, ligjit nr. 8402, datë 15.02.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit” i ndryshuar, Kreu III-të “Sanksionet” nenet 15 e 16, si dhe ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për Inspektoratin e Ndërtimit”.

-Mos arkëtim të gjobave të aplikuara në ndërtimet pa leje në vlerën 2,200,000 lekë, veprim në kundërshtim me nenin 15, të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 “Për inspektimin e ndërtimit”, mos kontabilizim në librat e llogarive dhe kontabilite si detyrime, veprime këto në kundërshtim me VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël”, kap I, si dhe mos penalizim në masën 2% për çdo ditë

vonesë, për mos derdhje në afat të gjobës deri në një muaj me vlerë **1,320,000 lekë**, veprime në kundërshtim me kreun IV-*Sanksionet* të nenit 16, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar.

-Të meta e mangësi e konstatuara në zbatimin e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar dhe VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e Prokurimit Publik”, i ndryshuar, në cilësinë e anëtarit të KVO në tenderat me objekt: “*Blerje karburanti për nevojat e bashkisë*” viti 2013, “*Rojet private*” viti 2014 dhe “*Rikonstruksion i rrethimit të varrezave të vjetra të qytetit Koplik*” viti 2014 dhe “*Mbikëqyrje punimesh në objektin Rikonstruksion i Rrugës Koplik Qendër*” viti 2013.

### **3. Z. XH.B. me detyrë Specialist në Zyrën e Kadastrës, për:**

-Kryerjen e shërbimeve "lagie rrugësh" në periudha të cilat nuk kanë qenë të parashikuara në kontratën nr. 616/1, datë 25.10.2012 e lidhur midis ish-Bashkisë Koplik dhe subjektit “Bajraktari Impex, veprime në kundërshtim me dispozitat të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve”.

-Mos zbatim të kushtet e kontratës së lidhur midis sipërmarrësit të shërbimit për pastrimin e qytetit të Bashkisë Malësi e Madhe (ish-Bashkisë Koplik) dhe ish-Kryetarit, të nenit 14, të kontratës nr. 616/1, datë 25.10.2012 “Për sipërmarrjen e shërbimeve publike të pastrimit, gjelbërimit, dekorimit dhe mirëmbajtjes të varrezave të qytetit të Koplikut, për mos aplikim dhe mbajtje të detyrimit mbi qiranë e përdorimit të mjeteve, duke lejuar përdorimin e tyre për nevoja personale, dhe përfituar të ardhura pa shpërblim ndajë buxhetit të Bashkisë Koplik (sot Bashkia Malësi e Madhe), njëkohësisht dhe rritur vlerën e amortizuar të këtyre mjeteve, si dhe mos arkëtim të vlerës së qirasë së mjetit për vitin 2013 në shumën **96,000 lekë**, veprime në kundërshtim me dispozitat e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe Udhëzimit të MF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve”.

-Mos administrimin e të ardhurave nga **11 objektet**, pronë e Bashkisë dhe shfrytëzuar nga të tretë, për qiranë në vlerën **5,925,600 lekë**, veprime në kundërshtim me VKM nr. 529, datë 08.06.2011 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar me VKM nr. 54, datë 05.02.2014.

-Të meta e mangësi e konstatuara në zbatimin e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar dhe VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e Prokurimit Publik”, i ndryshuar, në cilësinë e Kryetarit të KVO në tenderat me objekt; “*Rojet private*”, zhvilluar me 19.03.2013 “*Mbikëqyrje punimesh në objektin Rikonstruksion i Rrugës Koplik Qendër*” dhe “*Blerje kazanësh për mbeturina*”.

-Të meta e mangësi e konstatuara në zbatimin e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar dhe VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e Prokurimit Publik”, i ndryshuar, në cilësinë e anëtarit të KVO në tenderat me objekt; “*Blerje karburanti për nevojat e bashkisë*” viti 2013, “*Rojet private*” viti 2014 dhe “*Rikonstruksion i rrethimit të varrezave të vjetra të qytetit Koplik*” viti 2014.

### **4. Znj. N.D. me detyrë specialiste në Zyrën e Financës, për:**

-Mangësitë e konstatuara në shkelje të disiplinës financiare me dem ekonomik në vlerën **438,974 lekë**, në cilësinë e anëtarit të komisionit të blerjeve të vogla, nga mos zbatimi i



dispozitive të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullimet e prokurimit publik”, i ndryshuar me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, nenin 4, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, si dhe Udhëzimin e MF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

**5. Znj. A.I. me detyrë punonjës i Emergjencave Civile, për:**

-Mangësitë e konstatuara në shkelje të disiplinës financiare me dem ekonomik në vlerën **438,974 lekë**, në cilësinë e anëtarit të komisionit të blerjeve të vogla, nga mos zbatimi i dispozitive të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullimet e prokurimit publik”, i ndryshuar me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, nenin 4, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, si dhe udhëzimin e MF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

**6. Znj. V.Z. me detyrë ish-Përgjegjëse e Zyrës së Financës, Komuna Qendër, për:**

-Shmangie nga procedura të prokurimit me vlera të mëdha, veprime në kundërshtim me dispozitat e VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”lerë, i ndryshuar me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

-Mos argumentim të nevojave reale në përcaktimin e vlerës së kufirit monetar të mallrave dhe shërbimeve të ngjashëm, duke mos përcaktuar saktë sasinë vjetore dhe vlerën respektive të artikujve, bazuar në çmimet e publikuara nga INSTAT-I dhe institucionet e tjera shtetërore përkatëse, apo sipas testimi të tregut të dokumentuar, siç përcaktohet në Kreun II pikën 2, të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 dhe për pasojë ka shmangie nga procedura e konkurrimit të prokurimit duke përdorur pa drejtësisht procedurën “blerje me vlera të vogla.

-Të meta e mangësi e konstatuara në zbatimin e ligjit nr, 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar dhe VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e Prokurimit Publik “, i ndryshuar, në cilësinë e anëtarit të KVO në tenderin me objekt; “*Blerje kazanësh për mbeturina*” viti 2013.

**7. Z. B.B. me detyrë ish-Përgjegjës i Zyrës së Financës, Komuna Kastrat, për:**

-Shmangie nga procedura të prokurimit me vlera të mëdha, veprime në kundërshtim me dispozitat e VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”lerë, i ndryshuar me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

-Mos argumentim të nevojave reale në përcaktimin e vlerës së kufirit monetar të mallrave dhe shërbimeve të ngjashëm, duke mos përcaktuar saktë sasinë vjetore dhe vlerën respektive të artikujve, bazuar në çmimet e publikuara nga INSTAT-I dhe institucionet e tjera shtetërore përkatëse, apo sipas testimi të tregut të dokumentuar, siç përcaktohet në Kreun II pikën 2, të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 dhe për pasojë ka shmangie nga procedura e konkurrimit të prokurimit duke përdorur pa drejtësisht procedurën “blerje me vlera të vogla.

-Kryerjen e shpenzimeve për pastrimin e mbeturinave në Komunën Kastrat, pa argument

ekonomik dhe në kundërshtim me dispozitat e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, Udhëzimit të MF nr. 30, datë 27.12.2011 Për Menaxhimin e Aktiveve të Njesisë së Sektorit Publik”, si dhe nenet 5, 8, 10 dhe 21, të ligjit nr 8094, datë 21.03.1996 “Për largimin publik të mbeturinave”, për dëmin ekonomik në vlerën **396,000 lekë**.

#### **8. Z. B.D. me detyrë Përgjegjës i Zyrës së Taksave Vendore, Bashkia Malësi e Madhe, për**

-Mos planifikim i saktë i të ardhurave vendore, në raport me resurset që ka Bashkia Malësi e Madhe, ku evidentohet një mungesë të ardhurash në planifikim në vlerën **24,223,000 lekë**, veprime në kundërshtim me dispozitat e ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, Udhëzimin nr. 24, datë 02.09.2008, me ndryshimet, ligjin nr. 9920 dt. 19.05.2008 “Për procedurat tatimore”, me ndryshime, ligjin nr. 7776, datë 22.12.1993 “Për Buxhetin Lokal”, ndryshuar.

-Mos zbatim të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar dhe Kreu i XI “Mbledhja me forcë e detyrimeve”, ligjin nr. 9920 dt. 19.05.2008 “Për procedurat tatimore”, me ndryshime, për arkëtimin e debitorëve në vlerën **17,723,880 lekë**.

-Mos planifikim dhe arkëtim të të ardhurave nga taksa e fjetjes në hotel, të subjektit “A.H.”, në vlerën **919,800 lekë**, veprime në kundërshtim me ligjit nr. 9632 datë 20.10.2006 “Për sistemimin e taksave vendore”, i ndryshuar.

-Mos planifikim dhe arkëtim të të ardhurave nga taksa e ndërtesë, në **21 subjekte me vlerën 987,750 lekë**, veprime në kundërshtim me të ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar.

-Mos planifikim dhe arkëtim të të ardhurave nga taksa e reklamës në **7 subjekte me vlerë 3,122,550 lekë** veprime në kundërshtim me të ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar.

#### **9. Z. E.B. me detyrë Inspektor i Zyrës së Taksave Vendore, Bashkia Malësi e Madhe për:**

-Mos planifikim i saktë i të ardhurave vendore, në raport me resurset që ka Bashkia Malësi e Madhe, ku evidentohet një mungesë të ardhurash në planifikim në vlerën **24,223,000 lekë**, veprime në kundërshtim me dispozitat e ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, Udhëzimin nr. 24, datë 02.09.2008, me ndryshimet, ligjin nr. 9920 dt. 19.05.2008 “Për procedurat tatimore”, me ndryshime, ligjin nr. 7776, datë 22.12.1993 “Për Buxhetin Lokal”, ndryshuar.

-Mos zbatim të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar dhe Kreu i XI “Mbledhja me forcë e detyrimeve”, ligjin nr. 9920 dt. 19.05.2008 “Për procedurat tatimore”, me ndryshime, për arkëtimin e debitorëve në vlerën **17,723,880 lekë**.

-Mos planifikim dhe arkëtim të të ardhurave nga taksa e fjetjes në hotel, të subjektit “A.H.”, në vlerën **919,800 lekë**, veprime në kundërshtim me ligjit nr. 9632 datë 20.10.2006 “Për sistemimin e taksave vendore”, i ndryshuar.

-Mos planifikim dhe arkëtim të të ardhurave nga taksa e ndërtesë, në **21 subjekte me vlerën 987,750 lekë**, veprime në kundërshtim me të ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar.

-Mos planifikim dhe arkëtim të të ardhurave nga taksa e reklamës në **7 subjekte me vlerë 3,122,550 lekë** veprime në kundërshtim me të ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar.

### C/3. “Vërejtje” deri në “Zgjidhjen e Kontratës së Punës”.

#### **1. Z. A.RR. me detyrë Përgjegjës i Zyrës së Financës, Bashkia Malësi e Madhe, për:**

-Të meta e mangësi e konstatuara në zbatimin e ligjit nr, 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar dhe VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e Prokurimit Publik “, i ndryshuar, në cilësinë e anëtarit të KVO, në tenderin me objekt; “*Blerje kazan për mbeturina*” viti 2013 dhe cilësinë e Kryetarit të KVO, në tenderin me objekt; “*Mirëmbajtje objektësh*” viti 2015.

#### **2. Z. L.SH. me detyrë ish-përgjegjës Zyrës së Taksave Vendore, Komuna Qendër, për:**

-Mos planifikim i saktë i të ardhurave vendore, në raport me resurset që ka ish-Komuna Qendër, ku evidentohet një mungesë të ardhurash në planifikim në vlerën **1,186,000 lekë**, veprime në kundërshtim me dispozitat e ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “*Për sistemin e taksave vendore*”, i ndryshuar, Udhëzimin nr. 24, datë 02.09.2008, me ndryshimet, ligjin nr. 9920 dt. 19.05.2008 “Për procedurat tatimore”, me ndryshime, ligjin nr. 7776, datë 22.12.1993 “Për Buxhetin Lokal”, ndryshuar.

-Mos zbatim të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar dhe Kreu i XI “Mbledhja me forcë e detyrimeve”, ligjin nr. 9920 dt. 19.05.2008 “Për procedurat tatimore”, me ndryshime, për arkëtimin e debitorëve në vlerën **1,186,000 lekë**.

#### **3. Z. E.L. me detyrë ish-përgjegjës Zyrës së Taksave Vendore, Komuna Kastrat, për:**

-Mos planifikim i saktë i të ardhurave vendore, në raport me resurset që ka ish-Komuna Kastrat, ku evidentohet një mungesë të ardhurash në planifikim në vlerën **5,970,000 lekë**, veprime në kundërshtim me dispozitat e ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “*Për sistemin e taksave vendore*”, i ndryshuar, Udhëzimin nr. 24, datë 02.09.2008, me ndryshimet, ligjin nr. 9920 dt. 19.05.2008 “Për procedurat tatimore”, me ndryshime, ligjin nr. 7776, datë 22.12.1993 “Për Buxhetin Lokal”, ndryshuar.

-Mos zbatim të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar dhe Kreu i XI “Mbledhja me forcë e detyrimeve”, ligjin nr. 9920 dt. 19.05.2008 “Për procedurat tatimore”, me ndryshime, për arkëtimin e debitorëve në vlerën **5,803,000 lekë**.

#### **4. Z. N.R. me detyrë Përgjegjës i Zyrës së ATM dhe kadastrës, Komuna Kastrat, për:**

-Mos planifikim i saktë i të ardhurave vendore, në raport me resurset që ka ish-Komuna Kastrat, ku evidentohet një mungesë të ardhurash në planifikim në vlerën **5,970,000 lekë**, veprime në kundërshtim me dispozitat e ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, Udhëzimin nr. 24, datë 02.09.2008, me ndryshimet, ligjin nr. 9920 dt. 19.05.2008 “Për procedurat tatimore”, me ndryshime, ligjin nr. 7776, datë 22.12.1993 “Për Buxhetin Lokal”, ndryshuar.

### **5. Z. S.R. me detyrë ish-Përgjegjës i Zyrës së dhe kadastrës, Komuna Qendër, për:**

-Mos planifikim i saktë i të ardhurave vendore, në raport me resurset që ka ish-Komuna Qendër, ku evidentohet një mungesë të ardhurash në planifikim në vlerën **2,178,000 lekë**, veprime në kundërshtim me dispozitat e ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, Udhëzimin nr. 24, datë 02.09.2008, me ndryshimet, ligjin nr. 9920 dt. 19.05.2008 “Për procedurat tatimore”, me ndryshime, ligjin nr. 7776, datë 22.12.1993 “Për Buxhetin Lokal”, ndryshuar.

### **6. Znj. I.R. me detyrë Përgjegjëse e Ndhmës Ekonomike;**

-Të meta e mangësi e konstatuara në zbatimin e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar dhe VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e Prokurimit Publik”, i ndryshuar, në cilësinë e anëtarit të KVO, në tenderin me objekt; “*Blerje kazanësh për mbeturina*” viti 2013.

## **D. MASA ADMINISTRATIVE:**

Bashkia Malësi e Madhe të marrë masa që në mbështetje të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, nenet 15 e 16, për shkelje të neneve 7 dhe 12, të ligjit nr. 8402 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kreu II, pika 8.3, kontratën e mbikëqyrjes së punimeve me nr. 15, datë 01.03.2013, pikat 2, 5 dhe 6 si dhe VKM nr. 514, datë 15.8.2007 “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, pika 9, t’i kërkojë Kryeinspektorit të Inspektoratit Mbrojtjes Territorit Vendor, **të vlerësojë dhe të marrë masë administrative me gjobë për 3 mbikëqyrësit** e punimeve, si më poshtë:

**1. Inxhinier N.M.** në cilësinë e mbikëqyrësit, për shkeljet e konstatuara në procedurat e zbatimit të kontratës me pasojë dëm ekonomik ndajë buxhetit të njësisë vendore në vlerë totale **852,943 lekë** (pa t.v.sh), dhe mangësitë në dokumentacion, më konkretisht; në kontratën me objekt “*Rikonstruksioni i rrethimit të varrezave Kopluk*”, veprime në kundërshtim me nenin 7, të ligjit nr. 8402 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar dhe kontratën e mbikëqyrjes së punimeve nr. 54, datë 13.10.2014, pikat 2, 5, 6 dhe 22.

**2. Inxhinier R.GJ.** në cilësinë e mbikëqyrësit, për shkeljet e konstatuara në procedurat e zbatimit të kontratës e me pasojë dëm ekonomik ndajë buxhetit të njësisë vendore në vlerë totale **1,480,125 lekë** (pa t.v.sh), dhe mangësitë në dokumentacion, më konkretisht; në kontratën “*Gjelbërim i rrugës së Lagjes Culaj*”, veprime në kundërshtim me nenin 7, të ligjit nr. 8402 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, kontratën nr. 703/1, datë 10.12.2012 për mbikëqyrjen e punimeve, konkretisht pikat 2 dhe 20.

**3. Inxhinier G.L.** në cilësinë e kolaudatorit të punimeve, për shkeljet e konstatuara në procedurat e zbatimit të kontratës për katër investime (*trajtuar më hollësisht në raportin përfundimtar*) me pasojë dëm ekonomik ndajë buxhetit të njësisë vendore në vlerë totale **2,333,068 lekë** (pa t.v.sh), dhe mangësitë në dokumentacion, më konkretisht në kontratat: “*Rikonstruksioni i Murit Rrethues te Varrezave*”

*“Gjelbërim i rrugës së Lagjes Culaj”*

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme, bien në kundërshtim me nenin 12 të ligjit nr. 8402 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar dhe kontratën e kolaudimit së punimeve dhe Udhëzimi nr. 3 datë 15.02.200 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” e konkretisht Kreu II, Pika 3.

#### **E. Për punonjësit e larguar nga detyra dhe që nuk kanë adresim institucional:**

Për ish-punonjësit e mëposhtëm, masa disiplinore për shkeljet të natyrës administrative të konstatuara në auditimin e kryer në Bashkinë Malësi e Madhe, pavarësisht se ekzistojnë nuk mund të ezaurohen si të tilla, pasi nuk janë në marrëdhënie pune me këtë institucion dhe nuk ka adresim institucional për dhënie, ndjekje e zbatim. Në kushtet kur mos ushtrimi i detyrës administrative ka ndikuar në funksionimin administrativ të institucionit, atëherë ngarkohet Bashkia të njoftojë Departamentin e Administratës Publike për rezultatet e auditimit të KLSH<sup>së</sup> për këto ish-punonjës dhe marrjen e masave të mëtejshme nga ana e saj.

1. Znj. E.H. me detyrë Sekretare Kryetarit, në cilësinë e anëtarit të KVO.
2. Z. R.S. me detyrë inspektor kadastrë, në cilësinë e Kryetarit të KVO.
3. Z. F.B. me detyrë inxhinier, në cilësinë e anëtarit të KVO.
4. Z. I.B. me detyrë zv/Kryetar Bashkie, në cilësinë e Kryetarit të KVO.
5. Z. J.N. me detyrë ish-P/Zyrës Urbanistike, në cilësinë e anëtarit të KVO.
6. Z. XH.D. me detyrë specialist në Zyrën e Kadastrës, në cilësinë e anëtarit të KVO.
7. Z. N.Q. me detyrë zv/Kryetar, Komunës Kelmend, në cilësinë e kryetarit të KVO.
8. Z. K.L. me detyrë ish-arkëtar, në cilësinë e anëtarit të KVO, Komunës Kelmend.
9. Z. L.G. me detyrë ish-ins/punëve publike, në cilësinë e anëtarit të KVO, Komuna Kelmend.
10. Z. M.B. me detyrë ish-P/Zyrës së Ndhmës Ekonomike, në cilësinë e kryetarit të KVO, Komuna Qendër.
11. Z. H.M. në cilësinë e anëtarit të KVO, Komuna Qendër.
12. Z. L.SH. me detyrë ish-specialist në Zyrën e Tatim Taksave, në cilësinë e anëtarit të KVO, Komuna Qendër.
13. Znj. K.J. me detyrë ish-P/Zyrës së Financës, në cilësinë e kryetarit të Njësisë së Prokurimit Komuna Kelmend.
14. Z. E.L. me detyrë ish-Jurist, në cilësinë e kryetarit të Njësisë së Prokurimit, Komuna Qendër.

#### **E. VLERËSIMI I ZBATIMIT TË REKOMANDIMEVE**

KLSH do të ndjek me vëmendje të veçantë dhe vlerësojë dhe marrjen e masave, që do të marrë Bashkia Malësi e Madhe për zbatimin e rekomandimeve të dërguara nga auditimi i kryer, reflektimin e tyre në përmirësimin e proceseve të veprimtarisë ekonomiko-financiare, me qëllim mirë përdorimin e fondeve publike, në përputhje me parimet e ekonomicitetit, efikasitetit dhe efektivitetit në shërbim të komunitetit.

Në përfundim të afateve të përcaktuara në rekomandimet e dërguara dhe afatin e caktuar 6 muaj, në nenin 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe

*Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”, do të kryejmë auditim të veçantë, për ecurinë dhe nivelin e zbatimit të masave të rekomanduara.

Nga Bashkia Malësi e Madhe, nuk është kthyer përgjigje akoma, së bashku me planin e masave për zbatimin e rekomandimeve të dërguara nga KLSH, pasi nuk është ezauruar afati ligjor prej 20 ditë, pra rezulton se rekomandimet janë në proces vlerësimi.

**Shënim:** Auditimi është kryer nga audituesit shtetëror Kristaq Gjurgjaj, Hysen Metko, Xhovan Domi, Jonild Hoxhaj dhe Andon Frrokaj, më tej u shqyrtua nga z. Niko Nako kryeauditues, z. Xhaferr Xhoxhaj Drejtor i Departamentit, z. Ermal Yzeiraj, Drejtori i Departamentit Juridik, Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikës.

## **KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**